



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PEJË**

---

Numri i lëndës: 2022:004977

Datë: 26.12.2023

Numri i dokumentit: 05117416

Ep.nr.12/2022

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtarja Blerta Kelmendi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit K “A”, SH.A, me adresë rruga ”Xh. S”, F e P, rruga e T, p.n, Pejë, ndaj debitorit DPT B. B. Gj, adresa “N. T”, p.n, Pejë, me bazë juridike përmbartimore pagesa e borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit kundër Urdhrit të Përmbartuesit Privat Blerim Baloku, me seli në Pejë, P.nr./I.Br.1546/19, i datës 31.10.2019, jashtë seancës gjyqësore, me datë 26.12.2023, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I.APROVOHET PJESËRISHT SI I BAZUAR, prapësimi i debitorit DPT B.B.GJ adresa “N T”, p.n, Pejë, ashtu që SHFUQIZOHET pjesërisht Urdhri i Përmbartuesit Privat Blerim Baloku, me seli në Pejë, P.nr./I.Br.1546/19, i datës 31.10.2019, sa i përket shumës së borxhit në lartësi prej 646.92 euro.

II.REFUZOHET I PABAZUAR, pjesa tjetër e prapësimit të debitorit dhe MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor i Përmbartuesit Privat Blerim Baloku, me seli në Pejë, P.nr./I.Br.1546/19, i datës 31.10.2019, sa i përket shumës prej 113.40 euro.

**A r s y e t i m**

Kreditori K “A”, SH.A., me seli në Pejë, me datë 31.10.2019, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm- ekstraktet e verifikuara nga librat

afariste për pagesat e shërbimeve të bartjes së mbeturinave, për periudhën kohore nga data 01.06.2008 e deri më 30.09.2019, në shumën prej 760.32 euro.

Përmbauesi Privat duke vendosur në bazë të propozimit të kreditorit, ka nxjerrë Urdhrin P.nr./I.Br.1546/19, i datës 31.10.2019, duke lejuar përmbarimin e propozuar.

Debitori në afatin e lejuar ligjor, me datën 19.11.2021, ka parashtruar prapësim kundër këtij urdhri përmbarimor, nën arsyetimin se: B.B.GJ, nuk ekziston fare nëse doni vërtetoni nga librat afariste pranë organit kompetent, së dyti legjitimiteti pasiv pasi që shpija dhe lokali nuk janë pronë imja po e dikujt tjetër dhe se unë aty jam vetëm punëtor me pagë mujore. Lokali që fare nuk është i regjistruar nuk është pronë e imja dhe se lokal butik “B” nuk ekziston fare. As unë asnjë anëtar i familjes nuk ka marrë asnjë vërejtje apo shkresë me të cilën ne ngarkohemi për çfarëdo borxhi ndaj kreditorit pra ky borxh është inekzistent sepse kemi të bëjmë me parashkrim absolut nga se të gjitha obligimet periodike uji, rryma, mbeturina janë periodike dhe parashkruhet në afatin një vjeçar, duke i propozuar gjykatës që ta hudh poshtë propozimin.

Kreditori lidhur me pretendimet në prapësim nuk ka dhënë përgjigje në prapësim.

Gjykata në procedurën përmbaimore pasi ka shqyrtuar dhe vlerësuar prapësimin e palës debitore, si dhe shkresat e tjera të lëndës, ka gjetur se prapësimi është pjesërisht i bazuar.

*Shqyrtimi i ligjshmërisë së urdhrin përmbarimor dhe dokumentit të besueshëm.*

Në propozimin për përmbarim të kreditorit të datës 31.10.2019, të lejuar nga Përmbauesi Privat Blerim Baloku, me seli në Pejë, P.nr./I.Br.1546/19, i datës 31.10.2019, në bazë të dokumentit të besueshëm-ekstrakti nga librat afariste, nga ana e kreditorit është kërkuar borxhi për periudhën kohore nga data 01.06.2008 e deri më 30.09.2019, në shumën prej 760.32 euro, në emër të bartjes së mbeturinave.

Gjykata pas vlerësimit të dokumentit të besueshëm-ekstraktit nga librat afariste, mbi bazën e të cilit është filluar procedura përmbaimore, konsideron se i ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore në kuptim të dispozitës së nenit 29 par.1 pika 1.2 të Ligjit për Procedurën Përmbaimore (tutje LPP-së), që përcakton shprehimisht se: “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1. kambialet dhe çeqet me potest dhe faturë kthyesë, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës; 1.2. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”.

Në këtë drejtim, dokumenti i besueshëm, mbi bazën e së cilës është aprovuar edhe urdhri për përmbarim është i ligjshëm dhe në harmoni me par.3 të nenit 29 të LPP-së, që përcakton se *“Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata pas konstatimit të ligjshmërisë të urdhrin përmbarimor, gjen se prapësimi i debitorit se kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës së kreditorit për arkëtimin e borxhit në rrugë gjyqësore, është pjesërisht i bazuar konform nenit 378 par.1 të LMD-së së ish-RSFJ-së dhe nenit 360 par.1 të LMD-së.

Gjykata parashkrimin e borxhit për periudhën nga 01.06.2008 e deri më 18.12.2012, ka zbatuar dispozitat e LMD-së të ish RSFJ-së (i vitit 1978), si ligj në fuqi në kohën kur është krijuar marrëdhënia juridike civile, kurse nga 19.12.2012 e tutje, gjykata ka zbatuar dispozitat e Ligjit nr.04/L-077- të Marrëdhënieve të Detyrimeve LMD-së (të vitit 2012).

Gjykata konstaton se kreditori për një pjesë të kërkesës ka humbur afatin ligjor brenda të cilit do të mund të arkëtonte forcërisht borxhin përmes rrugës gjyqësore, saktësisht për borxhin që përfshin periudhën kohore nga data 01.06.2008 e deri më 31.12.2017, në shumë prej 646.92 euro për shkak të parashkrimit.

Kreditori propozimin për përmbarim, e ka paraqitur më datën 31.10.2019 dhe sipas vlerësimit të gjykatës, borxhi i krijuar nga ana e debitorit që nga data 01.06.2008 e deri më 31.12.2017 është parashkruar, sepse ka kaluar afati 1 vjeçar brenda së cilës kreditori ka pasur mundësi të kërkoj përmbushjen gjyqësore të detyrimit, referuar nenit 378 të LMD-së të ish-RSFJ-së: *“Parashkruhen për një vjet:kërkesa e kompensimit për livrimin e energjisë elektrike e të ngrohjes, gazit, ujit dhe shërbimet e spastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e pastërtisë, kur livrimi, respektivisht shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”* dhe nenit 360 par.1 pika 1.1 dhe par.2 të LMD-së që përcakton se *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: 1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake; 2. Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë. Kurse neni 341 par.1 i LMD-së përcakton se “Me parashkrim shuhet e drejta e kërkimit të përmbushjes së detyrimit.”*

Sa i përket rrjedhshmërisë së afatit të parashkrimit, tek këto kërkesa, afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga fundi i vitit në të cilën arrin kërkesa për pagesë. Në rastin konkret parashkrimi borxhit të datës 01.06.2008 ka filluar të rrjedhë në fund të vitit, respektivisht më 31.12.2008, ndërsa është parashkruar pas një viti respektivisht me 31.12.2009.

Nën të njëjtin arsyetim të rrjedhjes së parashkrimit, parashkrimi i borxhi i vitit 2009, ka filluar të rrjedhë në fund të vitit 2009, respektivisht me 31.12.2009, ndërsa është parashkruar me 31.12.2010.

Parashkrimi i borxhit të vitit 2010, ka filluar të rrjedhë në fund të vitit 2010, respektivisht, me 31.12.2010, ndërsa është parashkruar me 31.12.2011. Parashkrimi i borxhit të vitit 2011, ka filluar të rrjedhë në fund të vitit 2011, respektivisht, me 31.12.2011, ndërsa është parashkruar me 31.12.2012.

Parashkrimi i borxhit të vitit 2012, ka filluar të rrjedhë në fund të vitit 2012, respektivisht, me 31.12.2012, ndërsa është parashkruar me 31.12.2013. Ndërsa parashkrimi i borxhit të vitit 2014, ka filluar në fundin e 2014, ndërsa i njëjti është parashkruar me 31.12.2015.

Parashkrimi i borxhit të vitit 2015, ka filluar të rrjedhë në fund të vitit 2015, respektivisht, me 31.12.2015, ndërsa është parashkruar me 31.12.2016.

Parashkrimi i borxhit të vitit 2016, ka filluar të rrjedhë në fund të vitit 2016, respektivisht, me 31.12.2016, ndërsa është parashkruar me 31.12.2017. Parashkrimi i borxhit të vitit 2017, ka filluar të rrjedhë në fund të vitit 2017, respektivisht, me 31.12.2017, ndërsa është parashkruar me 31.12.2018.

Kurse, propozimi për përmbarrim nga kreditori është paraqitur me 31.10.2019, që në kuptim të nenit 360 par.1 të LMD-së, kreditori për këtë periudhë kohore, propozimin për përmbarrim e ka paraqitur jashtë afatit ligjor 1 vjeçar, me ç'rast, borxhi i krijuar për vitet 01.06.2008 e deri më 31.12.2017, në shumë prej 646.92 euro është parashkruar.

*Vendosja si në pikën II të dispozitivit të aktvendimit.*

Gjykata konstaton se debitori detyrohet ti paguaj kreditorit shumën prej 113.40 euro për shfrytëzimin e bartjes së mbeturinave, për periudhën kohore nga 01.01.2018 e deri më 30.09.2019, për shkak se borxhi i tillë për këtë periudhë nuk është parashkruar.

Kreditori me paraqitjen e propozimit për përmbarrim të datës 31.10.2019, e ka ndërprerë parashkrimin e borxhit për periudhën nga data 01.01.2018 e deri më 30.09.2019. Kjo për shkak

se parashkrimi i borxhit i vitit 2018 ka filluar të rrjedhë në fund të këtij viti, pra me 31.12.2018 dhe borxhi i vitit 2018 do të parashkruhej pas një viti, respektivisht me 31.12.2019, ndërsa borxhi i vitit 2019, do të parashkruhej me 31.12.2020, kurse kreditori propozimin për përmbarrim e ka paraqitur me datën 31.10.2019, brenda afatit ligjor 1 vjeçar, të paraparë me nenin 360 par.1 të LMD-së. Paraqitja e propozimit ka ndërprerë parashkrimin e borxhit në kuptim të nenit 369 par.1 të LMD-së, që përcakton se: *“Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrur kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”*.

Për këtë pjesë të detyrimit, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të aktvendimit, dhe debitori detyrohet që shumën prej 113.40 euro t’ia paguaj kreditorit.

Pretendimet tjera të debitorit se butiku Bujar Gjurkaj, nuk ekziston fare, se i njëjti është vetëm punëtor me pagë mujore në atë lokal si dhe që i mungon legjitimiteti pasiv pasi që shpija dhe lokali nuk janë pronë e tij por e dikujt tjetër gjykata i konsideron si të pabazuara, nga se nuk hyjnë në shkaqet e parapara nga neni 71 i LPP-së, e të cilat po që se ekzistojnë mund të pengojnë përmbarrimin e lejuar, po ashtu debitori pretendimet e tij nuk i ka mbështetur në prova, ashtu siç kërkohet me nenin 69 par. 4 të LPP-së, në të cilin thuhet se: *“Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura, provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, për ndryshe prapësimi do të refuzohet”*. Gjykata vlen të theksoj se pretendimi i debitorit që i mungon legjitimiteti pasiv, është i pabazuar dhe në kundërshtim edhe me ekstraktin afarist, në cilin ekstrakt figuron emrin i debitorit si Butik DPT “Buki” Bujar Gjurkaj.

Për më tepër, gjykata vlerëson se procedura përmbarrimore ka filluar mbi bazën e ekstraktit afarist nr.23970 dhe 2101686, në të cilin në cilësinë e konsumatorit është debitori që nga viti 2008 e deri në vitin 2019, ashtu siç është kërkuar edhe në propozimin për përmbarrim nga kreditori. Andaj duke marrë për bazë faktin se në procedurën përmbarrimore zbatohet parimi rigoroz dhe formal, përmes të cilit parim, gjykata nuk është e autorizuar të shqyrtoj pretendimet kontestuese të cilat mund të jenë bazë në ndonjë procedurë tjetër, mirëpo në procedurën përmbarrimore, gjykata është e kufizuar vetëm në shqyrtimin formal të elementeve të dokumentit të besueshëm ekstraktit afarist, e për të cilin gjykata më lartë në mënyrë të detajuar ka konstatuar se është i përshtatshëm për përmbarrim.

Gjykata thekson se në llogaritjen e parashkrimit të borxhit nuk ka zbatuar dispozitën e nenit 355 të LMD-së, që përcakton afatin 3 vjeçar të parashkrimit të detyrimeve të subjekteve afariste në kontratat komerciale, pasi që gjykata nuk ka pasur prova të dorëzuara nga kreditori se debitori

është subjekt afarist, sepse në propozimin për përmbarrim dhe në urdhrin për përmbarrim, nuk është identifikuar debitori si biznes përmes përshkrimit të numrit të biznesit apo numrit fiskal. Konstatimi në propozim për përmbarrim vetëm të fjalës “butik”, nuk është e mjaftueshme të konstatohet se debitori është subjekt afarist, andaj, nën këto rrethana gjykata parashkrimin e ka llogaritur duke u bazuar në nenin 360 të LMD-së.

Gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancën gjyqësore dhe atë referuar vendimit të GJEDNJ-së *Saccoccia kundër Austrisë* (Aktgjykim i datës 18 dhjetor 2008), pasi pretendimet e palëve kanë qenë qarta dhe të njëjtat ngërthenin çështje ekskluzivisht ligjore të cilat nuk e kanë bërë të domosdoshme mbajtjen e seancës publike, në ndërlidhje edhe me natyrën jo komplekse e çështjes, gjykata u bazua në nenin 73 paragrafi 1 të LPP-së, i cili përcakton se: *“Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përyjashtimisht gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit”*.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 29 par. 1 nënpar.2, nënpar.3 dhe par.3 lidhur me nenin 73 dhe nenit 77 par.1 dhe 5 të LPP-së dhe neni 360 par.1 dhe 2, lidhur me nenin 369 të LMD-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE PEJË

### DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL

2022:004977

Ep.nr.12/2022, me datë 26.12.2023.

G j y q t a r j a

---

Blerta KELMENDI

#### UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes Gjykatës Themelore në Pejë.